



Vllaznia në futboll për femra është skuadra e parë finaliste e Kupës së Shqipërisë për sezonin 2017-2018. Skuadra kampione dhe fituese e kupës në fuqi, padyshim që konsiderohet pretendentja për fitimin edhe të trofeut të rradhës në futbollin shqiptar të femrave. Në ndeshjen gjysmëfinale, atë të luajtur paraditen e së shtunës në Kamëz, ekipi shkodran i drejtuar nga trajneri Nikolin Leka ka patur përballë Kinostudion. Ndeshja nuk ka patur shumë rivalitet dhe Vllaznia ka fituar me rezultatin 4-1. Në pjesën e parë për të kanë shënuar Doçi dhe Djegsina duke bërë që pjesa e parë të përfundojë me rezultatin 2-0. Në minutat e para të pjesës së dytë kanë ardhur edhe dy gola të tjerë që këtë herë kanë patur për autore Paviçeviç dhe Grudën. Në minutat e fundit ndërkohë ka shënuar një gol por që nuk ka mjaftuar për asgjë. Përfundimisht 4-1 për Vllazninë e cila tashmë do te ndeshet ne finale me ekipin Tirana AS.

© vllaznia.al